



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNIH SLUŽBENIKA KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 2438/2010

Datë: 14.12.2010

Bazuar në nenin 101 paragrafi 2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenin 10 paragrafi 1.3 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli në mbledhjen -X- të mbajtur me datë 14 dhjetor 2010, pasi shqyrtoj raportet me rekomandime të Kolegjeve të Këshillit, me qëllim të respektimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil, lëshon këto

REKOMANDIME

I. Në funksionin mbikëqyrës për zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal, të cilat i nënshtrohen zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, duhet të ndermirren këto veprime:

1. Obligohen të gjitha institucionet në nivelin qendror dhe lokal që të bëjnë riorganizimin e njësive të personelit (burimeve njerëzore), konform nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
2. Pranimi në shërbimin civil të bëhet, sipas nenit 18 paragrafi 1 Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe pas përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit të njoftohen të gjithë kandidatët që kanë marrë pjesë në intervistim apo testim dhe të drejtën për tu ankuar në fund të procedurës.
3. Në rast të plotësimit të ndonjë pozite të lirë të nivelit drejtues të veprohet konform nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe konform nenit 10 paragrafi 1.2 dhe nenit 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të ftohet Këshilli që të marrë pjesë si vëzhgues në procesin e intervistimit të kandidatëve.

4. Sipas, nenit 21 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në rast se ndonjë nëpunësi civilë në punë provuese të cilit nuk është konfirmuar në pozicionin e punës, mund të paraqesë ankesë kundër këtij vendimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, në afat prej tridhjetë (30) ditësh prej komunikimit të vendimit nga njësia e personelit.
Në këtë rast Njësit e personelit nuk mund të filloj procedimin e procesit të rekrutimit të ri për këtë vend të punës, derisa të shqyrtohet dhe të merret vendim në Këshill.
5. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. (neni 30 paragrafi 4 i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës).
6. Të behet vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për të gjithë shërbyesit civil, konform nenit 33 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
7. Të organizohen trajnime për ngritje profesionale për të gjithë shërbyesit civil, konform nenit 35 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
8. Të formohen komisionet disiplinore dhe komisionet për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave, konform nenit 70 dhe nenit 82 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
9. Në rast të paraqitjes në komision disiplinor apo në komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të ndonjë nëpunësi civilë, sipas nenit 12 paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, këto komisioni duhet të zgjedhin ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditë.

II. Rekomandimet të përmbushen në afat prej dy muajve nga dita e pranimit të tij dhe të njoftohet Këshilli.

Rekomandimet u dërgohen:

- Kryetarëve të Komunave,
- Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive,
- Kryeshefave të Agjencive ekzekutive,
- Udhëheqësve të personelit dhe
- Arkivit të Këshillit.

